



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 28.04.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti Nr. të protk (APK-DPKI-06-1810/24/1), për zyrtarin e lartë z. Sami Tahiraga, Anëtar i Bordit të Ankesave ndaj Vendimeve të nxjerra nga njësia e ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganën e Kosovës, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë respektivisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, pasi që i njëjti ka hequr dorë nga funksioni menaxhues dhe i personit të autorizuar në bizneset private.
- II. Është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik për shkak se janë ndërmarr veprimet, konform nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, pasi që zyrtari ka dhënë dorëheqje nga funksioni drejtues në organizatë joqeveritare.
- III. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi respektivisht papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Sami Tahiraga, Anëtar i Bordit të Ankesave ndaj Vendimeve të nxjerra nga njësia e ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganën e Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: LPKI).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas kërkesës nga autoriteti përgjegjës dhe vet pala me kërkesën për vlerësimin e situatës së mundshme të konfliktit të interesit, pasi që siç theksohet në kërkesën e cila është drejtuar në Agjenci, përmes të cilës është kërkuar të bëhej verifikimi (*citojmë*), nëse: pozita e anëtarit - Kryesuesit të Bordit të Ankesave për vendimet e ATK-së dhe Doganave, duke ushtruar pozitën si me poshtë paraqet situatë të konfliktit të interesit :

1. Partner Auditimi dhe Drejtor Menaxhues, Auditor ligjor (I licencuar nga KKRF) në BDO Kosova me Numër (.) kompani profesionale e cila merret me shërbime Auditimi, Këshillimi etj.
2. Partner- Drejtor Menaxhues në BDO Consulting- KS NUI- (.) kompani profesionale e cila mire me shërbime profesionale, Këshillimi etj.
3. Aksionar i kompanisë Golden Properties NUI (.)
4. FRANCK KOSOVA SH.P.K.-Kompani PASIVE – Agjent i autorizuar
5. FoxIT Prishtina L.L.C.- Agjent i autorizuar
6. Kryetar I Bordit ne Instutin IAAB – OJQ Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditor të Certifikuar është themeluar me 15.01.2016 si organizatë jo qeveritare (OJQ).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ, duke trajtuar dhe shqyrtuar kërkesën për vlerësim të situatës së mundshme të konflikt të interesit apo papajtueshmërive eventuale në ushtrim të funksionit publik .

Sipas procedurës së paraparë Agjencia me qëllim të grumbullimit të informacioneve të nevojshme nga vet pala si dhe sqarimit të plot të çështjes së ngritur është ftuar në takim zyrtari në fjalë, me këtë rast i njëjti është njoftuar me procedurat për trajtimin e rasteve reth situatave të konflikt të interesit apo papajtueshmërive dhe kufizimeve eventuale gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Në këtë takim zyrtari z. Sami Tahiraga, i është bërë me dije se kërkesën e dërguar nga aji, Agjencia do ta trajtoj në kuptim të rregullave dhe procedurave që lidhen me sqarimet rreth sjelljeve të lejuara dhe të ndaluara të zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrës publike si dhe procedurave për detyrimet për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe private të zyrtarit gjatë ushtrimit të detyrës publike.

Në këtë kuptim, bazuar në informacionet e paraqitura në kërkesën e parashtruar, në këtë takim zyrtarit në fjalë i është sqaruar se mbajtja e pozitave menaxhuese në kompani private, njëkohësisht gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë publik, sipas legjislacionit në fuqi përcaktohet si papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik dhe bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konflikt të Interesit, konkretisht neni 13 i cili ka përcaktuar Papajtueshmëritë me ushtrimin e funksionit publik ku: *(Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*

Po ashtu edhe në nenin 15 të këtij ligji është përcaktuar obligimi për Transferimin e të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes, duke përcaktuar se: *Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e administrimit dhe drejtimit në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj. 2. Zyrtari i lartë, pronari i aksioneve, gjegjësisht pjesës së kapitalit në një ndërmarrje, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet t'i transferojë të drejtat e administrimit ose menaxhimit, apo drejtimit të ndërmarrjes tek ndonjë person i besuar. 3. Zyrtari i lartë, është i obliguar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga zgjedhja, vendosja ose emërimi në detyrën publike, të bëjë transferimin e të drejtave në udhëheqjen e ndërmarrjes në personin e besuar*

kurse brenda afatit prej pesë (5) ditësh nga data e transferimit të këtyre të drejtave ta njoftojë me shkrim Agjencinë mbi personin e besuar dhe evidencën e transferimit të të drejtave të menaxhimit.

II. Angazhimit si Kryetar i Bordit në: “Instituti IAAB-OJQ Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditor të Certifikuar” e themeluar si organizatë jo qeveritare (OJQ), është e rregulluar me nenin 14 pika 1 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku është përcaktuar çështja e Anëtarësisë në organizata joqeveritare e ku thuhet **se:** *Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to .*

Pas sqarimit dhe diskutimit të fakteve, zyrtari i lartë është pajtuar me sqarimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke deklaruar se: Sa i përket kufizimit apo papajtueshmërive eventuale që lidhen me personin e autorizuar në biznesin privat nuk ka pasur njohuri për ketë arsye i është drejtuar Agjencisë për të marr një sqarim ligjor, por është zotuar se pas sqarimeve të duhura në afatin sa me të shpejt do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik, duke hequr dorë nga funksionet menaxhuese dhe përfaqësuesit të autorizuar (në biznes), njëherit ka deklaruar se do të marr veprime konkrete rreth angazhimit edhe si Kryetar i Bordit në Institutin IAAB – OJQ Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditor të Certifikuar .

Në ndërkohë Agjencia, ka pranuar informacione zyrtare nga z. Sami Tahiraga, ku është njoftuar se janë ndërmarr veprimet e nevojshme që dëshmojnë se z.Sami Tahiraga, nuk ushtron me funksion menaxhues e as të personit të autorizuar në bizneset me emër: “BDO Kosova L.L.C, BDO Consulting KS L.L.C, FRANCK KOSOVA SH.P.K, si dhe FoxIT Prishtina L.L.C., ku dhe edhe përmes informatës zyrtare nga ARBK-ja, dëshmohet se i njëjti nuk figuron më të jetë person i autorizuar në këto biznese, po ashtu nga zyrtari z. Sami Tahiraga, kemi pranuar edhe njoftimin për dorëheqjen nga angazhimit si Kryetar i Bordit në Institutin IAAB – OJQ Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditor të Certifikuar, të konfirmuar edhe nga Drejtori ekzekutiv i kësaj OJQ-je.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari e lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë dhe kufizimit në ushtrimin e funksionit publik respektivisht konflikti i interesit.

III. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*, Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

Ylli BULESHKAI
Drejtori Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)